



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	28 - 10 - 2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMST04	6526/2022		116



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.749/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.749/2022 të datës 31.08.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Pagarushë kundër Vendimit me Nr. 01/1189 të datës 27.07.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 , nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.10.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.749/2022 e datës 31.08.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr. 01/1189 i datës 27.07.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te Komisioni Disiplinor i Komunës së Malishevës.
- III. Obligohet Komisioni Disiplinor i Komunës së Malishevës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të bëjë zbatimin e këtij vendimit, të bëjë rishqyrtimin e këtij rasti.
- IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Malishevës që të kujdeset për zbatimin e të njëjtit ,si në pikën III të këtij vendimi.



V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Malishevës, më datë 31.08.2022 përmes e-mailit [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5042/2022 e cila po të njëjtën ditë është regjistruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 01/1189 të datës 27.07.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës për shkak të shkeljeve procedurale, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Malishevës, ndërsa Këshilli më datë 15.09.2022, me numër protokolli 5419/2022, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Malishevës, me shkresat e bashkangjitura.

Për shkak të specifikave të lëndës, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas kërkesës së kryetarit të kolegjit më datë 13.10.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.118/2022 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova:** Ankesën e ankuesit me nr. protokolli 5042/2022 të datës 31.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër 01/1189 i datës 27.07.2022 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Malishevës; Procesverbal me numër 01/1190 i datës 27.07.2022 i Komunës së Malishevës; Raport Specialistik Endokrinologjik i datës 24.02.2022; Vërejtje me shkrim me numër 05/149 e datës 29.04.2022; Raporti nga Ordinanca specialistike "Gastromed" AFM i datës 29.04.2022; Vërejtje me shkrim me numër 05/201 e datës 30.05.2022; Shkresë nga Drejtoria e Urbanizimi e datës 30.05.2022; Vërejtje me shkrim me numër 05/229 e datës 10.06.2022; Shkresë nga spitali rajonal Prizren e datës 10.06.2022; Kërkesë për shqyrtim në Komisioni Disiplinor me numër 05/303 e datës 14.06.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën 01.01.2018 deri 31.12.2018 e D.K. e datës 31.12.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i D.K. pa datë; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i D.K. i datës 09.06.2020; E-mail nga D.K. për [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) i datës 31.08.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 06.09.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 5419/2022 e datës 15.09.2022; Akt Emërim i D.K. me Nr.01/178 i datës 24.01.2012; Aktivitetet e punëtorit në komunën e Malishevës D.K. hyrje daljet 1/12 faqe; E-mail nga G.B. për C.Z. i datës 07.10.2022; E-mail nga C.Z. për G.B. i datës 07.10.2022; Vendim për formimin e Komisionit Disiplinor me numër 01/1179 i datës 15.12.2021 i Komunës së Malishevës; Akt Emërim i H.GJ. me Nr.01/229



i datës 01.03.2019; Akt Emërim i F.D. me Nr.01/1132 i datës 01.08.2018; Akt Emërim i V.K.Z. me Nr.01/321 i datës 10.03.2017; Vendim me numër protokolli 6143/2022 i datës 13.10.2022; Pliko me numër R2544818 i datës 13.09.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në **rishqyrtim dhe rivendosje** te organi i njëjtë që ka vendosë në lidhje me masën disiplinore, **SEPSE**:

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka gjetur se ankuesi në bazë të Akt Emërimit me Nr.01/178 të datës 24.01.2012 është i punësuar në pozitën "Zyrtar i Urbanizmit" në Drejtorinë e Urbanizmit Komuna e Malishevës. Në bazë të shkresave të lëndës ndaj zyrtarit D. K. janë shqiptuar tri vërejtje me shkrim nga Drejtori i Urbanizmit në Komunën e Malishevës për mosrespektim të orarit të punës me datën 29.04.2022 me numër protokolli 05/149, poashtu me datë 30.05.2022 me numër protokolli 05/201 dhe përsëri me datë 10.06.2022 me numër protokolli 05/229 vërejtje me po të njëjtën arsyeje. Ndërsa me datë 14.06.2022 me numër protokolli 05/303 Drejtori për Urbanizëm në Komunën e Malishevës ka parashtruar kërkesë për shqyrtim në Komisionin Disiplinor për zyrtarin D.K. Komisioni Disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë të ankuesit, me datë 06.07.2022 ka mbajtur mbledhjen e parë dhe ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, poashtu me datë 12.07.2022 është ftuar zyrtari në fjalë për shkeljen e supozuar dhe pas pyetjeve të bëra nga kryetari i komisionit për ankuesin për vërejtjet e bëra nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë se a jeni njoftuar për vërejtjet me shkrim nga Drejtori, i njëjti i është përgjigjur po jam njoftuar për vërejtjet që mi ka shqiptuar, poashtu mbikëqyrësin që e kam z. A.M e kam njoftuar me gojë që kam prindin e sëmurë për këto ditë që kam munguar ose jam vonuar, kur mu ka shqiptuar vërejtja e dytë unë kam paraqitur një raport të punës me datën 29.04.2022 po nuk kam klikuar tek sistemi i hyrje-daljes në institucion dhe raporti i punës është nënshkruar me datë 30.04.2022. Komisioni ka kërkuar nga D.K. që ti sjell raportet e mjekut për prindin dhe raportin e punës që është përgatitur nga ai, që ti sjell në zyrën e personelit brenda dy ditëve. I njëjti e ka kundërshtuar vërejtjen sepse nuk është njoftuar Drejtori për dalje në teren për mbikëqyrje dhe i ka bashkangjitur disa raporte të punës dhe mjekësore.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Malishevës më datë 27.07.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 01/1189 përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar Masa Disiplinore "Ndalim të pagës prej 40% të pagës bruto, për një periudhë gjashtë (6) muaj dhe Ndalim i ngritjes në detyrë prej dy (2) viteve.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 01/1189 të datës 27.07.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës për shkak të shkeljeve procedurale, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe ligjshmërinë e Vendimit me Nr. 01/1189 të datës 27.07.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se në bazë të provave të lëndës, në seancën e parë të Komisionit Disiplinor të mbajtur më datë 06.07.2022 ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës që kanë të bëjnë me këtë rast dhe me datë 12.07.2022 është ftuar ankuesi që të marrë pjesë në



cilësinë e palës në procedurë, ndërsa inicuesi i procedurës disiplinore, eprori i ankuesit D.K. nuk është ftuar që të merr pjesë në seancë të komisionit disiplinorë përkundër që ka inicue rastin në komision disiplinor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar shkresave të lëndës vë në spikamë nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafin 3.3 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: *"Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: "Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit"*, në këtë rast Kolegji i Këshillit, konstaton se mospjesëmarrja e inicusit të procedurës disiplinore si rezultat i mungesës së ftesës për të njëjtin paraqet shkelje të kësaj dispozite për faktin që pa marr parasysh kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore inicuesi i procedurës disiplinore duhet të ftohet në seancë të komisionit disiplinorë dhe përveç kësaj, duhet të jenë njëkohësisht në seancë bashkë me nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore me qëllim që të paraqesin argumentet e tyre me qëllim të ballafaqimit të fakteve, nga se kjo dispozitë është e karakterit imperativ dhe nuk i lehet në diskrecion komisionit disiplinor të vlerësoj sa i përket çështjes së prezencës së inicusit të rastit në komision disiplinor, andaj mbi këtë elementë konstatohet se mungesa e ftesës dhe si rezultat i saj edhe mosprezenca e inicusit të procedurës disiplinore në lidhje me ankuesin në komision disiplinor me qëllim të ballafaqimit të fakteve paraqet shkelje të dispozitave ligjore-procedurale që rregullojnë këtë aspekt dhe që u specifikuan më lartë.

Poashtu referuar shkresave të lëndës dhe duke marrë për bazë Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 47, ka përcaktuar se: *"Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"*, ku për shkelje të lehta jepen masa disiplinore të përcaktuara në nënparagrafin 1.1 të nenit 47 ndërsa për shkelje të rënda jepen masat disiplinore të përcaktuara me nënparagrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji. Në rastin konkret të ankuesit Komisioni Disiplinor i Komunës së Malishevës, përmes Vendimit me Nr. 01/1189 të datës 27.07.2022, i ka shqiptuar masat disiplinore *"Ndalim të pagës prej 40% të pagës bruto, për një periudhë gjashtë (6) muaj dhe Ndalim i ngritjes në detyrë prej dy (2) viteve*, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesit i janë shqiptuar dy masa disiplinore në të njëjtën kohë dhe përmes një vendimi edhe pse ndaj tij është iniciuar një procedurë disiplinore për një shkelje të rëndë të detyrave të punës, ndërsa në bazë të nenit 50 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *"Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore"*, rrjedhimisht Komisioni Disiplinor nuk mund të shqipton dy masa disiplinore për një shkelje andaj në këtë kuptim përmes këtij vendimi të atakuar kemi shkelje të dispozitave ligjore-materiale përkatëse që rregullojnë çështjen e shqiptimit të masave disiplinore.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe duke marrë për bazë shkresat e lëndës, kolegji i këshillit konstaton se Komisioni Disiplinorë me rastin e shqyrtimit të rastit të ankuesit përkatësisht shqiptimin e masave disiplinore nuk ka arritur të konstatoj saktë elementet e





përgjegjesisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht Vendimi me Nr. 01/1189 i datës 27.07.2022 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Malishevës, nuk përmban dispozitiv të qartë, po ashtu edhe arsyetimi është kundërthënës siç parashihet me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ndërsa arsyetimi i tij është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 48 të këtij ligji, i cili parasheh se: *“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”*.

Nga të lartcekurat, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me Nr. 01/1189 i datës 27.07.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale dhe dispozitave materiale, atëherë i njëjti sipas Kolegjit të Këshillit është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që në kuptim të dispozitave ligjore të zbatueshme të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Komisioni Disiplinor i Komunës së Malishevës është i obliguar që të rishqyrtoj rastin e ankuesit dhe në riprocedur të mënjanojë shkeljet procedurale dhe të veproj konformë dispozitave të ligjit material, dhe të rishqyrtoj rastin e ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke marr parasysh të gjitha rrethanat e rastit si dhe duke marr parasysh përveç tjerash edhe nenin 13 paragrafi 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.749/2022, datë 28.10.2022

Çlirim Zeka

*Çlirim Zeka*

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

*Arben Mehmeti*  
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;